



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI
TEL: 684055554

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 805
Tirane më 15/06/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020050710032597980



**KONTRATË SHIT-BLERJE
E KUOTAVE TË KAPITALIT**
*Në bazë të Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008
për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"*

Sot më datë 11 Qershor 2020 (dymijë e njëzet) ditën e enjte para meje Noterit Sokol Sh. MALAJ, Noter në Degën Vendore të Noterisë Tiranë me seli në Rr."L.Gurakuqi" u paraqitën personalisht:—

PALA SHITËSE:

Z. ATEO XHAKO i biri i Ali dhe Lindita lindur në Ersekë, Kolonjë më 25.07.1995, banues në Tiranë, Rr"Muhamet Deliu", i pajisur me Kartën e Identitetit #031447102# me Nr personal #J50725031F#, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355683041418.—

PALA BLERËSE:

Z. MUSTAFA SELENICA i biri i Xhaferr dhe Hysnije lindur në Ersek, Korçë më 12.03.1934, banues në Tiranë, Rr"Abdi Toptani", Torre Drini Nr 142, i identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr personal #D40312072D#, bashkëlidhur këtij akti noterial.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët pasi u sqaruan për pasojat juridike që sjell ky akt noterial, deklaruan se lidhin Kontratën e shitblerjes të kuotave të kapitalit me kushtet si vijon:—

Shitësi **Z. ATEO XHAKO** është ortak i vetëm i Shoqërisë "AdCity" shpk e regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 01.10.2018 me Nr unik të identifikimit të subjektit NIPT-L82201021K, e cila ndodhet me seli në Tiranë, Rr"Abdi Toptani", Torre Drini, Ap 132, dhe me Administrator **Z. ARLIND ZAJMI**.—

Pala shitëse **Z. ATEO XHAKO**, si ortak i vetëm i Shoqërisë, me vullnetin e tij të lirë e të plotë i shprehur me Vendimin Nr—1, të datës 11.06.2020 të Ortakut të vetëm të Shoqërisë "AdCity" shpk, ka vendosur –shitjen me Akt Noterial të 100% të kapitalit (*pra, të shoqërisë, kapitalit, asetëve, të drejtave dhe detyrimeve që ka kjo shoqëri*) — në favor të **Z. MUSTAFA SELENICA**.—

Në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve jashtë kësaj zyre, shitësi **Z. ATEO XHAKO** deklaron se është dakord që kuotën e tij të kapitalit prej 100% (*pra, të shoqërisë, kapitalit, asetëve, të drejtave dhe detyrimeve që ka kjo shoqëri*) që ai zotëron në shoqërinë "AdCity" shpk, t'ia shesë blerësit **Z. MUSTAFA SELENICA** në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë).—

Pala Blerëse deklaron se përpara nënshkrimit të këtij akti noterial ka likuaduar jashtë kësaj tyre noteriale me para në dorë (CASH) vlerën prej 100.000 Lekë (njëqind mijë).—

Edhe Blerësi Z. MUSTAFA SELENICA deklaron se pranon të blejë këtë kuotë të kapitalit në shoqërinë e mesipërme në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo që i është likuaduar plotësisht palës shitëse jashtë kësaj zyre noteriale me para në dorë (CASH).—

Veç sa më sipër, Blerësi deklaron se është dakord që të blejë këtë shoqëri me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ajo ka. Blerësi deklaron se është në dijeni të plotë të gjendjes aktuale financiare të kësaj shoqërie, se ka kontrolluar librat e kontabilitetit dhe se nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje.—

Me likuidimin e plotë të vlerës së shitjes, pra të çmimit prej 100.000 Lekë (njëqind mijë) shitësi Z. ATEO XHAKO e humbet të drejtën e pronësisë e për rrjedhojë të cilësisë së Ortakut të Vetëm në shoqërinë tregëtare “AdCity” shpk, ndërsa Blerësi Z. MUSTAFA SELENICA fiton pronësinë në kuotën 100% duke u bërë kështu Ortak i Vetëm i shoqërisë.—

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësi Z. ATEO XHAKO e humbet të drejtën e pronësisë në këtë shoqëri dhe Ortak i vetëm i ligjshëm e kësaj Shoqërie, në kuotën 100%, dhe Administrator bëhet blerësi Z. MUSTAFA SELENICA.—

Blerësi është i detyruar të paraqesë pranë Q. K. B. Vendimin e Ortakut të vetëm dhe aktin noterial të shitjes se kuotave në favor të ortakut të vetëm Z. MUSTAFA SELENICA.—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo kontrate Shit-Blerje e kuotave të kapitalit e cila pasi u lexua nga palët dhe u gjet sipas vullnetit të palëve, u nënshkrua në praninë time sipas ligjit dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

PALA SHITËSE:

Z. ATEO XHAKO

Ateo Xhako
[Signature]

PALA BLERËSE:

Z. MUSTAFA SELENICA

[Signature]
[Signature]

**NOTERI
SOKOL SH. MALAJ**

**TAKSA E PULLES
U PAGUA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRIE
NOTER
TIRANË**

[Signature]

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR"LUJGJ GURBUKUCI" P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kolimalaj@hotmail.de

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SOKOL SH. MALAJ

DATE 15/06/2020
NR REP 805

V2020050710032597980



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15 Qershor 2020 (dy mijë e njetzet), ditën e hene, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqiten personalisht:

DEKLARUESIT:

Z. ATEO XHAKO, atësia Ali, amësia Lindita, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Kolonjë dhe banues në TIRANE, me adresë 1040 Linzë Muhamet Deliu 69 2 16, lindur më 25/07/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031447102 dhe nr. personal J50725031F .

Z. MUSTAFA SELENICA, atësia Xhafer, amësia Hisnije, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Korçë dhe banues në TIRANE, me adresë Tiranë B.Biba A 41 A 42, lindur më 12/03/1934, gjendja civile "i ve", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031953669 dhe nr. personal D40312072D .

Deklaruesit e mësipërm, me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Kontrate shitblerje e kuotave të Kapitalit lëshuar më datë 11/06/2020, në Shqipëri nga Noter Sokol Sh. Malaj", bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
SOKOL SH. MALAJ

